



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1024/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Muhamet Thaqit – Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) dega në Kamenicë, për shkak të vjedhjes së votave, për të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1024, Anr.1025, Anr.1026, Anr.1027, Anr.1028, Anr.1029, të datës 03.12.2013, të Muhamet Thaqit – Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Kamenicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1024, Anr.1025, Anr.1026, Anr.1027, Anr.1028, Anr.1029, të datës 03.12.2013 nga Muhamet Thaqi – Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Kamenicë, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur pa rregullsi të shumta si dhe vjedhje të votave.

- Në ankesën Anr.1024/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 1024D/02R dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.
- Në ankesën Anr.1025/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 10050/01R dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.
- Në ankesën Anr.1026/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 1009D/04R dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.
- Në ankesën Anr.1027/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 1009D/03R dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.
- Në ankesën Anr.1028/13 të datës 03. 12.2013, pretendohet se në VV1009D dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.
- Në ankesën Anr.1029/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 1009D/01R dyshoj se në të njëjtin VV mu është vjedhur vota për delegat.

Bazuar ne nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Muhamet Thaqit – Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionerëve në Këshillat e Vendvotimit KVV dega në Kamenicë, ku të njëjtit kanë bërë pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit si dhe vjedhje të votave nëpër VV në Kamenicë, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në VV, e lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1024/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.